



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Këshilli Drejtues i Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbështetje të paragrafi I, nënparagrafi h të vendimit nr. 937 të datës 20.05.2019, në mbledhjen e mbajtur me 10.06.2020, nxjerr:

V E N D I M

- I. Afati i pagesës së taksës administrative të anëtarësimit për vitin 2020 për anëtarët e regjistruar të OSK-së, shtyhet deri në datën 01 tetor 2020.
- II. Ndaj anëtarëve të OSK-së të cilët kanë humbur afatet për parashtrim të aplikacionit për regjistrim, licencim, rilicencim dhe shërbime tjera të OSK-së (gjatë muajve mars, prill, maj) nuk do të zbatohen gjobat administrative për vonesa në aplikime për muajt e lartëcekur.
- III. Gjobat administrative nga paragrafi II nuk pezullohen për stomatologët të cilët kanë licencë të punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (pavarësisht nëse është licencë me afat apo e skaduar) dhe të cilët për kundër paralajmërimeve të OSK-së dhe dispozitave të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nuk janë anëtarësuar në OSK.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, duke pasur parasysh vendimin e Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. 21/III/2020 të datës 20/03/2020 me të cilin u ndalua veprimtaria e punës së institucioneve private stomatologjike dhe qarkores informative nr. 1137 të datës 16/03/2020 me të cilin u pezullua puna e organeve në zyret e OSK-së gjatë kësaj periudhe, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Komisionit të regjistrimit dhe licencimit
- Komisionit të regjistrimit dhe licencimi

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof.Dr. Blerim Kamberi

